

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit S. B., sh.p.k. me seli në fsh. Ll., Komuna e Lipjanit, kundër të paditurës Termokos sh.a. në Prishtinë, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas revizionit të së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.190/2017 datë 5.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27.11. 2017, mori këtë,

#### A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i së paditurës Termokos sh.a.në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.190/2017 datë 5.09.2017,që i referohet pagesës së borxhit në shumë prej 16,259.62 €.

II.PRANOHET revizioni i të paditurës përkitazi me lartësinë prej 8% të kamatës së gjykuar me aktgjykimin e sipërpërmendur, ashtu që në këtë pjesë aktgjykimi i goditur NDRYSHOHET dhe detyrohet e paditura që paditësit shumë e lartcekur t'ia paguajë me kamatë në lartësi të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dt.30.04.2013 e deri në pagesën definitive.

#### A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike Ek.nr.181/2017 dt.15.06.2017, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit,

kundër të paditurës, lidhur me kërkesën për pagesën e borxhit në shumën prej 16,259,62 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dt.30.04.2013 e deri në pagesën definitive dhe është vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore t'i bartin secila palë veç e veç.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.190/17 dt.5.09.2017 është pranuar ankesa e paditësit si e bazuar dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike Ek.nr.181/2017 dt.15.06.2017 dhe është detyruar e paditura Termokos sh.a. në Prishtinë që paditësit "S. B." sh.p.k., t'i paguajë borxhin në shumë prej 16,259.62 €, së bashku me kamatën në lartësi prej 8% nga dt.30.04.2013 e deri në pagesën definitive si dhe që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor e paditura ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë apo të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së dytë ashtu që të vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Përgjigje në revizion ka paraqitur pala paditëse, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 lidhur me nenin 505 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i së paditurës është pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, fillimisht, paditësi ka parashtruar propozim për përbarim me dt.30.04.2013 lidhur me pagesën e borxhit në shumën prej 16,259.62 €, ndaj palës së paditur, për periudhën nga dt.25.07.2010 deri 29.09.2010, sipas shumave të faturave të arritura për pagesë deri më 29.09.2010. Nga fletë dërgesat që gjenden në shkresat e lëndës rrjedhë se e paditura ka pranuar derivate nga paditësi, këto fletë dërgesa përmbajnë datën e furnizimit, organizatën, automjetin për të cilin është bërë furnizimi respektivisht targat e tij, numrin e

identifikimit të vozitësit, sasinë e derivateve dhe çmimin e përgjithshëm, nënshkrimin e vozitësit dhe kujdestarit të pompës, të cilat fletë dërgesa mbështetën edhe në faturat që gjenden në shkresat e lëndës nga të cilat rezulton se e paditura është furnizuar nga paditësi por nuk e ka paguar çmimin e derivateve të pranuar. Ky konstatim rrjedhë edhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar V. I., të dhënë në ekspertizën me shkrim të dt.22.12.2014, sipas të cilës detyrimi i së paditurës ndaj paditësit është 16,259.62 euro.

Duke u nisur nga gjendja e këtyre faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se, nuk është kontestues borxhi i së paditurës ndaj paditëses që rezulton nga faturat që gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo, marrëdhënia kontraktuale midis palëve ndërgjyqësve ka qenë jo valide pasi është krijuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 52 dhe 210 të LMD-së dhe nenit 19,26 par.1 dhe 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, Nr.04/L-042, prandaj, gjykata e shkallës së parë, kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, nuk ka pranuar konstatimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se në mënyrë të gabuar e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, për çka ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj. Kështu, Gjykata e shkallës së dytë thekson se sipas nenit 67 të LMD-së, në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve nuk është e domosdoshme lidhja e ndonjë kontrate formale. Nga provat e administruara rrjedhë se mallrat janë pranuar sipas fletë dërgesave që gjenden në shkresat e lëndës, paditësja sipas kërkesës së të paditurës ka dorëzuar mallrat e kërkuara dhe i ka dërguar faturat përkatëse për derivatet e furnizuara, është krijuar obligimi i së paditurës për borxhin e papaguar dhe se në kuptim të nenit 26 dhe nenit 67 si dhe nenit 42 par.3,4,5 të LMD-së, është krijuar raporti detyrimor. Në rastet kur lidhja e kontratës, respektivisht furnizimi nuk është kryer sipas procedurës së paraparë ligjore, kontrata është e ndaluar vetëm për porositësin për të cilin zbatohen rregullat përkatëse, ndërsa, organizatave zbatuese nuk iu ndalohet lidhja e kontratave të cilave nuk iu ka paraprirë procedura paraparë ligjore. Edhe pse e paditura thirret në dispozitivin e nenit 26 par.1 dhe 2 të Ligjit të Prokurimit Publik i cili parasheh se “kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me par.1 dhe 2 të këtij neni

janë të pa zbatueshme” dhe e paditura, bazuar në këtë dispozitë kërkon lirim nga detyrimi, mirëpo, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se dispozita e cituar krijon detyrime për vet të paditurën. Pazbatueshmëria e kontratës nënkupton nulitet të saj dhe në këtë rast neni 103 par.2 i LMD-së përcakton se ”Në qoftë se lidhja e kontratës së caktuar është e ndaluar vetëm për njëri anë kontrata do të mbetet në fuqi, në qoftë se me ligj nuk është parashikuar diçka tjetër për rastin e caktuar, ndërsa pala që ka shkelur ndalesën ligjore do të bartë pasojat përkatës”, ndërsa, neni 104 par.1 përcakton se” Në rastin e nulitetit të kontratës secila palë kontraktuese ka për detyrë t’ia kthejë palës atë që ka marrë në bazë të kontratës së tillë e në qoftë se kjo nuk ka mundësi apo nëse vetë natyra e sajë që është plotësuar i kundërvihet kthimit duhet të jepet kompensimi përkatës në të holla sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor në qoftë se ligji nuk cakton diçka tjetër. Prandaj, nga këto arsye, Gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimin të sajë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë(përveç, për lartësinë e kamatës), është marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale. Aktgjykimi përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Thëniet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi se janë të paqëndrueshme për faktin sepse janë dhënë arsyet e duhura për faktet relevante me rëndësi për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridiko-civile. Kështu, nëpërmjet zhvillimit dhe vlerësimit të provave dhe shkresave të lëndës(faturave, fletë dërgesave, ekspertizës së ekspertit financiar etj) në kuptim të nenit 8 të LPK-së, janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë faktet se midis palëve ndërgjyqësore ishte krijuar raporti detyrimor i sipër theksuar, nga i cili e paditura i ka mbetur borxh paditësit për shumën prej 16,259.62 euro.

Kështu, në kontekst të raportit detyrimor të sipër cekur, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 15.1 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se "Në krijimin e kontratave të dyanshme pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke "(Parimi i ekuivalencës së prestimeve), kurse, me dispozitën e nenit 17.1 të njëjtë Ligj, parashihet se "Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit janë të detyruar të përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij". Kjo Gjykatë, konsideron se është i drejtë përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë si dhe arsyet e dhëna, kur në rastin konkret juridiko-civil, ka zbatuar dispozitat e nenit 67, nenit 103 par.2, nenit 104 par.1 të LMD-së, etj, dhe ka obliguar të paditurën që paditësit t'i paguajë borxhin në shumën e lartë cekur. Përveç kësaj që u sipër theksua, edhe sipas institutit të së drejtës detyrimore, Pasurimit të pa bazë, kur e paditura ka pranuar mallin, kurse nuk ka paguar çmimin, i ka mbetur borxh paditësit, në shumën e lartë cekur, rezulton se ka fituar pa bazë, ndaj, është e detyruar t'i kthejë mallin paditësit, nëse kjo është e mundur, në të kundërtën është e obliguar të kompensojë vlerën e fitimit të arritur (neni 210 i LMD-së).

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se nuk qëndron po ashtu as pretendimi i revizionit lidhur me mungesën e legjitimitetit real pasiv të së paditurës, kjo për faktin sepse, në bazë të shkresave të lëndës, faturave, fletë dërgesave etj., rezulton se e paditura është palë me legjitimitet real pasiv. Për palën përkatëse ndërgjyqësore thuhet se është me legjitimitet real, në qoftë se ajo është pjesëmarrëse në raportin materialo-juridik nga i cili ka lindur kontesti, siç është rasti konkret këtu me palën e paditur.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare lidhur me aplikimin e së drejtës materiale, gjeti se lartësia e kamatës për shumën e sipër cekur, nuk është e gjykuar në përputhje me dispozitën e nenit 277 të LMD-së, pasi që kamata në lartësi prej 8%, nuk është e thënë që të jetë e njëjtë në të gjitha bankat vendore, prandaj, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me kamatën, është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nga këtu, e konform dispozitës së nenit 224.1 të LPK-së, u vendos si në pjesën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 dhe 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.E.nr.22/2017 datë 27.11.2017

Kryetari i kolegjit  
Mr.Sc.Muhamet Rexha